

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government

Për:	Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Glllogocit Labinot Halilaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Glllogocit	
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë Sekretari i Përgjithshëm i MEA-së	
Nga:	Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme në MPL	Data: 14.08.2020
Zyrtarët përgjegjës:	Venera Çerkini, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Vjosa Ahmetaj, Zytare e lartë për monitorim të komunave	Nr. 020-545/5
Lënda:	Raporti i vlerësimit të ligjshmërisë së aktit të Komunës së Glllogocit	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Ministria e Pushtetit Lokal, ka pranuar Vendim 12 Nr. 633/04-28765 për shpalljen e lokalitetit të Boshtres (Forsythea europea) në Zonën e Goleshit - fshatin Sankoc në kategorinë - Monument i Natyrës, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Glllogocit, dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Glllogocit, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.



Duke u bazuar në nenin 7, të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, aktin e lartshënuar e kemi dërguar në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit si institucion përgjegjës për shqyrtimin e ligjshmërisë.

Bashkangjitur gjeni raportin e vlerësimit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
Ministarstvo Ekonomije i Zivotne Sredine
Ministry of Economy and Environment



Për:	Goran Rakić, Ministër në MAPL Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme në MAPL
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Blerim Kuçi, Ministër i MEA Mentor Sylmeta, ud. Sekretar i Përgjithshëm i MEA
Nga:	Floriqe Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor
Zyrtarët përgjegjës:	Sabrije Rama, Udhëheqëse e Divizionit për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit, të Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës

I nderuar Minister,
E nderuar Sekretare,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Rregulloren (QRK) Nr. 07/2020 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm

të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje
Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi 12 Nr. 633/04- 28765, dt. 30.07.2020 për shpalljen e lokalitetit të Boshtres "Forsythia
Europaea" në Zonën e Goleshit – fshati Sankoc në kategorinë Monument i Natyrës, miratuar
nga Kuvendi Komunal Glllogoc

I miratuar me datë: 30.07.2020

I parashtruar për shqyrtim në MAPL me datë: 03.08.2020

I dërguar për shqyrtim në MEA, me datë: 05.08.2020

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më
sipër, vlerëson se akti i komunës nuk është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në
fuqi.

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, mbetet në dispozicion të MAPL dhe komunës për çfarëdo
sqarimi të mëtejshme në lidhje me këtë vlerësim.

Rekomandim:

I rekomandohet Komunes së Glllogocit që Vendimin ta shpall në Gazetën Zyrtare të Republikës së
Kosovës dhe një kopje të Vendimit ta dergojë në MEA, respektivisht në Institutin e Kosovës për
Mbrojtjen e Natyrës, për regjistrim të vlerës së mbrojtur në Regjistrin Qendror të Vlerave të
Mbrojtura të Natyrës.



Republika e Kosovës
Komuna e Gllgocit
Kuvendi i Komunës



12 Nr 633/04-28765 dt. 30/07/2020

Bazuar në nenin 11,12, dhe 40, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 34, pika 34.6, të Statutit të Komunës së Gllgocit, në bazë nenit 19 paragrafi 3 të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës Nr.03/L-233, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.85 e dates, 09 nëntor 2010, nenit 58 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 e datës 04 qershor 2008. Kuvendi i Komunes së Gllgocit, në mbledhjen e mbajtur më 30. 07. 2020, miratoj këtë:

V E N D I M

PËR SHPALLJEN E LOKALITETIT TË BOSHTRES (*FORSYTHIA EUROPEA*) NË ZONËN E GOLESHIT- FSHATIN SANKOC NË KATEGORINË - MONUMENT I NATYRËS

Neni 1

Me këtë Vendim shpallet nën mbrojtje Lokaliteti i Boshtres (*Forsythia europea*) në zonën e Goleshit – fshatin Sankoc të Gllgocit, në kategorinë Monument i Natyrës (këtu e tutje: Monument i Natyrës).

Neni 2

Sipërfaqja e Zonës së mbrojtur të Monumentit të Natyrës në Komunën e Gllgocit është 38.42 hektare, ndërsa paraqitja hartografike me përmasa 1 :25000 paraqitet në Shtojcen e bashkëngjitur të këtij Vendimi.

Neni 3

Për Monumentin e Natyrës përcaktohet regjimi mbrojtës i shkallës së III-të, të mbrojtjes në të cilën përcaktohen masat dhe kushtet vijuese me të cilat:

Në Monumentin e Natyrës ndalohet:

- a) Shfrytëzimi i resurseve natyrore,
- b) Prerja e trungjeve dhe çfarëdo veprimtarie e cila ndryshon gjendjen e tanishme,
- c) Ndezja e zjarrit në sipërfaqen e mbrojtur,
- d) Ndryshimi i pamjes së sipërfaqen së mbrojtur,
- e) Hedhja e mbeturinave në sipërfaqen e mbrojtur,
- f) Aktivitete tjera të cilat mundë të shkaktojnë ndryshime ose dëmtime të Monumentit të Natyrës.

Në Monumentin e Natyrës lejohet:

Të gjitha masat e mbrojtjes biologjike-teknike të Monumentit të Natyrës nën kushtet të cilat i përcakton Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe në bazë të Projektit për sanimin e

gjendjes së Monumentit të Natyrës si dhe punët teknike të cilat janë në funksion të mbrojtjes të Monumentit të Natyrës.

Neni 4

Për zbatimin e masave dhe kushteve të përcaktuara, kujdeset Komuna e Glllogocit përmes Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe është e detyruar që:

- a) Monumentin e Natyrës ta mbroj, ta ruaj dhe mirëmbajë në pajtim me kushtet e përcaktuara të mbrojtjes,
- b) Në rast të paraqitjes të ndryshimeve të cilat Monumentin e Natyrës mundën ta shkatërrojnë ose t'i dëmtojnë vetitë e rëndësishme të tij, menjëherë të lajmëroj Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës,
- c) Të bëjë shënjimin e kufijve të Monumentit të Natyrës në pajtim me Rregulloren për Shënjimin e Zonave të Mbrojtura.

Neni 5

Planet hapësinore dhe urbanistike, projektet, bazat ekonomiko-pyjore duhet të harmonizohen me masat dhe kushtet për mbrojtjen e Monumentit të Natyrës.

Neni 6

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Drejtorisë Përkatesë;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit .



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labinot Halilaj